



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:115202

Datë: 24.12.2021

Numri i dokumentit: 02550642

**PPP.nr.1/20**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Shtërpc**, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbaremore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “SCARDIAN”, J.S.C, me seli në Prishtinë, rr “Perandori Justinian”, nr.69, kundër debitorit B.F. nga Prizreni, rr “...”, nr..., për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga personi i tretë S.S. nga fsh ..., Komuna e Shtërpcës, me datë 24.12.2021, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si i pabazuar prapësimi i personit të tretë S.S., i ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbaremit P.nr.2635/19, i datës 26.09.2019, i lëshuar nga përmbareusi privat Isa Gacaferi nga Prishtina dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbaremit P.nr.2635/19, i datës 26.09.2019.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin mbi lejimin e përmbaremit P.nr.2635/19, i datës 26.09.2019, përmbareusi privat Isa Gacaferi nga Prishtina, e ka caktuar përmbareimin e propozuar nga kreditori Kompania e Sigurimeve “SCARDIAN”, J.S.C, kundër debitorit B.F., për pagesën e shumës së borxhit prej 1,528.00 euro, në bazë të aktgjykimit C.nr.1505/18, të datës 11.02.2019, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbaremore, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përmbareusit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, personi i tretë S.S. ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që të shpallet si i palejueshëm përmbarimi në veturën e markës “OPEL”, tip “CORSA”, me targa të regjistrimit ....

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e personit të tretë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i personit të tretë si pabazuar dhe të mbeetet në fuqi urdhëri për përmbarim.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhërin për përmbarim P.nr.2635/19, të datës 26.09.2019 dhe pretendimet në prapësim të personit të tretë S.S. dhe vlerësoj se prapësimi është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata me rastin e rishikimit të procedurës së përmbarimit konform nenit 43, par 4, të LPP-së, vlerësoj se urdhëri për përmbarim P.nr.2635/19, i datës 26.09.2019, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore ngase përmbaruesi privat në këtë rast e ka lejuar përmbarimin e propozuar në pajtim me nenin 29, par 1, nën par 1.2, të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të personit të tretë në prapësim se automjeti i udhëtarëve në ditën e lidhjes dhe vërtetimit të kontratës ka kaluar në pronësinë time para marrjes së vendimit për përmbarim, respektivisht para marrjes së vendimit për përmbarim, Gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse nga shkresat e lëndës respektivisht nga prova e bashkangjitur nga personi i tretë prapësimi të tij siq është kontrata për shitblerjen e automjetit “OPEL”, tip “CORSA”, me targa të regjistrimit ..., nr Ref.nr.16839/2018, e datës 07.12.2018, konstatohet se në bazë të nenit 7 të kontratës në fjalë, është përcaktuar se: e drejta në pronësi në automjetin në fjalë fitohet në momentin e pranimit-dorëzimit dhe regjistrimit në Qendrën për Regjistrimin e Automjeteve dhe blerësi vetë, kopjen e kontratës ia dorëzon Qendrës për Regjistrim të Automjeteve, ashtu që nga provat e personit të tretë në prapësim nuk shihet se ka ndonjë provë që personi i tretë ta ketë dorëzuar kontratën në fjalë në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve dhe pastaj ta ketë fituar të drejtën e pronësisë mbi automjetin i cili është objekt përmbarimi në këtë rast. Andaj, Gjykata në mungesë të pronësisë së plotë mbi automjetin nga personi i tretë nuk mund ta shpall përmbarimin si të palejueshëm në automjetin e markës “OPEL”, e tipit “Corsa”, me targa të regjistrimit ....

Andaj, Gjykata bazuar në nenin 4 dhe 73, par 1, 2 dhe 3, 75 dhe 76, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Shtërpc**  
**PPP.nr.1/20, më datë 23.12.2021**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykates së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.